

Specifikimi i Produktit Rregullat e Tregtimit - Shtojca 1

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike

SPECIFIKIMET E PRODUKTIT – TREGU FIZIK

HYRJE

1.1 Të përgjithshme

Ky Specifikim Produkti aplikohet së bashku me Rregullat e tregtimit në tërësinë e tyre, me rregulla e rregullore të mëtejshme lidhur me Produktet që janë paraqitur në Tregun Shqiptar të Ditës në Avancë.

1.2 Referencat Kohore

Referencat për pikat në kohë i referohen kohës CET, për sa kohë nuk është specifikuar ndryshe, koha është përcaktuar në formatin 24 orësh. Referencat ditore janë për ditët kalendarike për sa kohë nuk janë specifikuar ndryshe.

Ndryshimi i kohës së shkurtuar:

Në ditën e orës së shkurtuar në Mars (fillimi i kursimit të kohës verore), do të ketë vetëm 23 orë në ditën e Tregut Spot, kështu që ora ndërmjet 02:00 dhe 03:00 do të kapërcehet atë ditë.

Ndryshimi i kohës së zgjatur:

Në ditën e ndryshimit të kohës së zgjatur në Tetor (fundi i kursimit të kohës verore), do të ketë 25 orë në ditën e Tregut Spot. Llogaritja e zakonshme e çmimit të ditës më parë dhe programet mbulojnë 25 orë. 25 orët duhet të raportohen dhe dy orët ndërmjet 02:00 dhe 03:00 mund të trajtohen si dy orë të ndryshme.

1.3 Shlyerjet Cash

Shlyerjet CASH për shpërndarjet që kryhen në çdo ditë shpërndarjeje do të kryhen si më poshtë, pavarësisht Shërbimit të Produkteve:

- i Për secilën faturë me Sasi Neto Shlyerjeje CASH që i kanë borxh BSHEE:
 - a. Dita e shpërndarjes + 1 ditë
- ii Për çdo faturë me Sasi Shlyerjeje CASH që BSHEE ka borxh:
 - a. Dita e shpërndarjes + 2 ditë

Rregulla dhe procedura të mëtejshme lidhur me Shlyerjen CASH dhe Shpërndarjen janë përcaktuar në Rregullat e Tregut.

2 TREGU SHQIPTAR I NJË DITE MË PARË

2.1 Të përgjithshme

- 2.1.1 Metoda e kuotimit: Dërgimi i vazhdueshëm i Porosive deri në Mbylljen e Portës, duke ndjekur Porositë eliminatore që do të përputhen dhe duke përdorur metodën e Ankandit të përcaktuar në rregulloret e Tregut Shqiptar të një Dite më Parë.
- 2.1.2 Orët e Tregimit: 24 orët që vijnë duke filluar nga 00:00 CET.
- 2.1.3 Mbyllja e Portës: 12:00 CET
- 2.1.4 Porcioni i Tregimit: 0,1 MW
- 2.1.5 Madhësia e Impulsit: Euro 0.1/MWh
- 2.1.6 Monedha: Porositë mund të dërgohen në Euro. Llogaritja e çmimit në Euro.
- 2.1.7 Tipat e Porosive: Porosi Orare
- 2.1.8 Hapat e Çmimit: Numri i Hapave të Çmimit është 64 (përfshirë Çmimet e Porosive Kufi, të sipërm e të poshtëm)
- 2.1.9 Çmimi teknik i Porosisë Kufi të ulët: Euro – 500.
- 2.1.10 Çmimi teknik i Porosisë Kufi të lartë: Euro + 3000.
- 2.1.11 Shpërndarja: Siç specifikohet në Porosi.
- 2.1.12 Shlyerjet Cash: sipas nenit 1.3 të kësaj shtojce, Llogaritjet e shlyerjeve do të bazohen në Livrimet konkrete për Orë Livrimi në secilën Ditë Livrimi në fuqi.

2.2 Kodet e Kontratës të Tregut Shqiptar të një Dite më Parë:

Prapashtesa (e ndryshueshme)	Shpjegimi	Diapazoni
dd	Dita e muajit (dy shifra)	01 - 31
mm	Muaji i vitit (dy shifra)	01 - 12
yyyy	Viti (katër shifra)	Viti korrent (viti tjetër)
nn	Ora	00:00 – 24:00

2.3 Orët e Tregut Shqiptar të një Dite më Parë

Kontratat për çdo javë (nga e Hëna në të Dielë) do të hapen normalisht për Porositë në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë dy javë në avancë. Nëse e Hëna është ditë pushimi, kontratat do të hapen ditën e punës që vjen në rradhë. Lidhur me periudhat e pushimeve, java e tregimit mund të hapen më herët, ndërsa në lidhje me zbatimet teknike java e tregimit mund të hapet më vonë, vetëm sipas gjykimit të BSHEE.